



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E
KADASTRËS

DHOMA KOMBËTARE E
NOTERISË

Nr. 185 Prot. Dk 0801.2020

Nr. 177 Prot. Dk 08.01.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, (shkurt ASHK) në cilësinë e personit juridik publik, në varësi të Kryeministrit, që ka objekt të veprimtarisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme private dhe të drejtave reale mbi to, në zbatim të Ligjit Nr. 111/2018 "Për Kadastrën", përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Artan LAME**,

DHE

DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË, (DHKN) në cilësinë e personit juridik, sipas kompetencave të njohura me Ligjin nr. 110/2018 "Për Noterinë", përfaqësuar nga Kryetarja **Zj. Mimoza SADUSHAJ**,

Referuar në vijim si palë;

Duke siguruar pavarësinë në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe realizimin në kohë reale të shërbimit publik kundrejt shtetasve palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 1

Baza ligjore

Palët në këtë Memorandum ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me statusin e tyre juridik, dhe kuadrin ligjor si:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

-Kodi Civil

-Ligji Nr. 111/2018 "Për Kadastrën"

-Ligji Nr. 110/2018 "Për Noterinë",

- Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 2

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka si qëllim përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet palëve në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi, në lidhje me evidentimin, regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme dhe të të drejtave të tjera reale mbi to. Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi, në bazë të besimit reciprok dhe mirëbesimit ndërinstitucional, angazhohen të mundësojnë krijimin e lehtësive të ndërsjellta për realizimin e një shërbimi publik sa më profesional dhe efikas.

Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore në bazë dhe për zbatim të të cilëve lidhet ky memorandum.

Neni 3 Angazhimet e palëve

Palët janë të gatshme angazhohen që në zbatim të kësaj marrëveshje :

- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacionin për çështje të veçanta, për të cilat institucionet kanë interes të përbashkët, në respektim të ligjeve të posaçme të sipërcituara;
- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte juridike, literaturë juridike, tipologji, interpretime ligjore, rregullore dhe çdo lloj informacioni/materiali që lidhet me fushën e zbatimit të këtij memorandumi bashkëpunimi;
- Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, trajnime, konsultime, etj, për shkëmbimin e përvojave profesionale në funksion të përmirësimit të punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni përkatës në fuqi dhe nga kjo marrëveshje;
- Të bashkëpunojnë për formimin teknik, juridik e profesional të stafeve respektive, për realizimin sa më efikas dhe profesional të shërbimit publik ndaj shtetasve;
- Të sigurojnë komunikimin teknologjik online ndërmjet tyre, në lidhje me marrjen e informacioneve mbi të gjitha të dhënat që disponojnë në lidhje me pasuritë e paluajtshme dhe të të drejtave të tjera reale mbi to;
- Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij memorandumi.

Procedurat e trajtimit të aplikimeve online të noterëve dhe ndërveprimi elektronik ndërmjet palëve në funksion të këtyre aplikimeve, do të realizohen sipas përcaktimeve të aneksit nr.1 që i bashkëlidhet kësaj marrëveshje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 4 Detyrimet e palëve

1. Agjensia Shtetërore e Kadastrës në zbatim të kësaj marrëveshje ka detyrë:

- a. Të informojë në kohë Dhomën Kombëtare të Noterisë mbi problematikat e konstatuara gjatë regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat lidhen me kryerjen e veprimeve dhe veprimtarisë së noterëve.
- b. Të bashkëpunojë me Dhomën Kombëtare të Noterisë në mënyrë të ndërsjelltë dhe periodike, në lidhje me hartimin ose përmirësimin e rregulloreve, udhëzimeve, qarkoreve apo akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e ASHK-së dhe që lidhen me fushën e qëllimit të këtij memorandumi.
- c. Të informojë Dhomën Kombëtare për çdo akt nënligjor që nxjerr A S H K , apo edhe çdo informacion tjetër, që lidhet me veprimtarinë noteriale.
- d. Të përcaktojë me qartësi në kartelën e pasurisë së paluajtshme të dhënat e pasurisë, zonën ku ndodhet prona, origjinën e pronës bashkëlidhur aktit, të bashkëlidhë kopje të dokumentacionit të pronësisë kur kërkohet nga noterët, përkundrejt tarifave të shërbimit kadastral sipas legjislacionit në fuqi, si dhe tatimin/taksën që duhet paguar në kuadrin e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme.
- e. Të mundësoj nëpërmjet sistemit elektronik të Kadastrës, marrjen, procesimin dhe kthimin e pergjigjeve të Aplikimeve Elektronike të dërguara nga noterët nëpërmjet ndërveprimit të Sistemit Elektronik të DH.K.N.-së me Sistemin Elektronik të ASHK në kohë reale, duke shfrytëzuar Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.
- f. Angazhohet të bashkëpunojë me Dhomën Kombëtare të Noterisë për përcaktimin e tematikave të trajnimeve të përbashkëta.

2. Dhoma Kombëtare në zbatim të kësaj marrëveshje ka detyrë :

- a. Të informojë ASHK-në në lidhje me të gjitha aktet që lidhen me veprimtarinë e saj dhe që janë në fushën e qëllimit të kësaj marrëveshje.
- b. Të informojë noterët nëpërmjet trajnimeve, seminarëve dhe takimeve, për realizimin me korrektësi të veprimtarisë noteriale lidhur me transaksionet e pasurive të paluajtshme, regjistrimin e pasurive dhe të të drejtave reale mbi to në ASHK, si dhe përditësimin e vazhdueshëm të tyre me informacione shtesë.
- c. Të realizojë njohjen e anëtarëve të saj me praktikën e punës me sistemin e krijuar elektronik, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, nëpërmjet aksesit online në regjistrat e pasurive të paluajtshme.
- d. Të sensibilizojë noterët, për të ruajtur dhe respektuar konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave kadastrale, të siguruara nga aksesit në regjistrat elektronik të ASHK-së, në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
- e. Të orientojë dhe asistojë noterët që të kenë qasje të drejtpërdrejt në të gjitha të dhënat në formë elektronike dhe gjithnjë të përditësuara, që lidhen me punën e tyre dhe të këshillojnë palët e përfshira.
- f. Të orientojë noterët që kërkesat e tyre të përcillen me mjete të sigurta elektronike nga zyrat noteriale në regjistrat kompetent shtetëror.
- g. Të orientojë noterët të hartojnë akte të nënshkruara elektronikisht, të cilat janë njësoj detyruese për regjistrat sikurse aktet noteriale në formë dokumenti në letër.

Neni 5 Komunikimi

Rregulli i përgjithshëm i shkëmbimit të informacionit është ai shkresor dhe/ose elektronik. Palët për zbatimin e këtij memorandumi caktojnë nga një person kontakti, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e tij, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

Për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, person i kontaktit do të jetë _____, me këto kontakte:

Email: _____

Për Dhomën Kombëtare të Noterisë, person i kontaktit do të jetë punonjësi i IT Lysieu Ali me këto kontakte:

Email: lysieu.ali@duaq.al

Palët angazhohen të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën, me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 6 Interpretimi


Çdo nen i parashikuar në këtë memorandum dhe në aneksin bashkëlidhur tij, do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së memorandumit dhe në funksion të qëllimit të palëve në krijimin e këtij bashkëpunimi.

Neni 7 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet mes palëve.

Neni 8 Ndryshimet

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellët me shkrim të palëve.



Neni 9
Përfundimi i Memorandumit

1. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, për sa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

Neni 10
Dispozita të fundit

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve.
2. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e këtij Memorandumi, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tij.
3. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme secila palë të informojë titullarin e institucionit.
4. Cdo aneks për të cilin palët do të bien dakord dhe do të nënshkruajnë në të ardhmen, i cili do të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij Memorandumi, do të konsiderohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.
5. Memorandumi dhe aneksi bashkëlidhur përgatiten në gjuhën shqipe dhe nënshkruhen në 4 (katër) kopje origjinale, të hartuar nga palët në vullnet të lirë e të plotë me të njëjtën përmbajtje dhe formë, dy prej të cilave depozitohen në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe dy në Dhomën Kombëtare të Noterisë.


Shfuqizohet Memorandimi i Bashkëpunimit Nr.5767/1092 Prot, datë 13.06.2014 dhe Udhëzimi i Përbashkët Nr.285/1 Prot-1213 Prot., datë 19.10.2016

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 08/01/2020.

AGJENCIA KOMBËTARE E KADASTRËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTAN LAME



DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

KRYETARË E DHOMËS

MIMOZA SADUHAJ



ANEKSI 1

MËNYRA E NDËRVEPRIMIT ELEKTRONIK, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE ONLINE TË NOTERËVE NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Të Përgjithshme

Ky aneks teknik është pjesë përbërëse dhe e pandarë e Marrëveshjes Dy -Palëshe të Bashkëpunimit ndërmjet Dhomës Kombëtare të Noterisë (DHKN-së) dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Aneksi hartohet për të mundësuar aksesin e noterit në të dhënat e Regjistrat Shtetëror Elektronik të Kadastrës. Aksesi i parashikuar përmes marrëveshjes së bashkëpunimit dhe këtij aneksi lidhen me ushtrimin e veprimtarisë publike të noterit të rregulluar në ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe Kodin e Etikës Profesionale të Noterit.

Komunikimi i sigurt elektronik përmes zyrës noteriale në regjistrat publik të administruara nga ASHK, siguron përpunimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit që përdoret për hartimin e aktit noterial të fitimit, kalimit dhe tjetërsimit të të drejtave pronësore. Përmes këtij komunikimi elektronik sigurohet për të dy palët pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit siguri juridike dhe mundësi për qytetarët për marrjen e shërbimeve publike “one stop shop”. Siguria e komunikimit midis palëve ndërvepruese si aktorët kryesorë të komunikimit (DHKN dhe ASHK), do të garantohet nga Platforma Qeveritare e Ndërveprimit në kuptimin e autentifikimit dhe certifikimit elektronik të aplikimeve që shkëmbehen ndërmjet tyre.

Komunikimi i sigurt elektronik midis DHKN-së dhe ASHK-së do të realizohet duke garantuar plotësimin e parakushteve të nevojshme ligjore dhe teknike në lidhje me realizimin e aplikimit të certifikuar elektronik, i cili kërkon që:

- noterët të kenë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat në formë elektronike që disponohen nga ASHK dhe që lidhen me veprimtarinë e tyre noteriale;
- kërkesat të dërgohen me mjete të sigurta elektronike nga zyrat noteriale;
- noterët hartojnë akte të nënshkruara elektronikisht
- ht, të cilat kanë të njëjtin efekt juridik sikurse aktet noteriale të hartuara në formën hardcopy.

A.1. Kuadri ligjor që garanton implementimit dhe ndërveprimin elektronik midis palëve

Për Dhomën Kombëtare të Noterisë (DHKN)

Ligji nr. 110/2018 datë 20.12.2018 “Për Noterinë” (Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti 2019- Nr. 16 / 13 shkurt 2019). Kodi i Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhrin 445 të Ministrisë të Drejtësisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti 2019- Nr. 142.)

Për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK)

Ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën" dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore të dalë në funksion dhe për zbatim të këtij ligji.

B. Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online

Agjencia Shtetërore e Kadastrës ofron për noterët dhe nëpërmjet tyre, të paktën 27 shërbimet online sipas listës në pjesën fundore të këtij aneksi, kundrejt tarifave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Përveç këtyre 27 shërbimeve, palët e kësaj marrëveshje mund të ofrojnë online edhe shërbime të tjera kadastrale, në varësi të mundësive teknike-infrastrukturore të tyre. Shërbimet për noterët dhe nëpërmjet tyre, mund të ofrohen ose sipas afateve standarde të ligjit nr. 110/2018/ "Për kadastrën", ose në mënyrë të përshpejtuar.

- Pranë ASHK-së do të funksionojë një regjistër i veçantë për aplikimin online të noterëve, si dhe një regjistër për përpunimin e kërkesave për aplikim dhe lëshimin e dokumenteve.
- Noterët paraqesin kërkesën/aplikimin online për shërbimin përkatës nëpërmjet sistemit elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Kjo kërkesë, përveç të dhënave dhe dokumentacionit që kërkon ligji, duhet të përmbajë edhe adresën e saktë të noterit dhe numrin e kontaktit të tij. Aplikimi/kërkesa bëhet në bazë të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës me të cilin noterët identifikohen në platformën e Dhomës Kombëtare të Noterisë.
- Për realizimin e këtyre shërbimeve, ASHK ka detyrimin të caktojë specialistët përkatës nga stafi i tij, të cilët do të bëjnë përpunimin e kërkesave të noterëve sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara me ligj.
- Për kryerjen e pagesave përkatëse në lidhje me shërbimet e kërkuara, ASHK vë në dispozicion të noterëve numrat e llogarive bankare përkatëse.
- Me kryerjen e pagesës për shërbimin e kërkuar, noteri bën aplikimin online në sistemin elektronik të ASHK-së, nëpërmjet Platformës Elektronike NISA, e cila identifikon noterin me përdorues dhe fjalëkalim të caktuar.
- Me kryerjen e aplikimit noteri duhet të skanojë online gjithë dokumentacionin e praktikës së aplikuar. Pjesë e dokumentacionit të skanuar duhet të jenë edhe mandat-pagesat e kryera për shërbimin e kërkuar, përveç rasteve kur pagesa mundësohet dhe verifikohet drejtpërdrejt nëpërmjet sistemit (payment gateway). Mandat-pagesa duhet të jetë në përputhje me vlerën e transaksionit të kryer të përcaktuar në aktin noterial dhe vlerën e tarifave të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin e ofruar.
- Pas dërgimit online të aplikimit, noteri ka detyrimin që brenda afatit 3 ditor (ditë pune) të bëjë depozitimin e dokumentacionit origjinal që shoqërojnë aktet noteriale, ose brenda ditës – për shërbimet e shpejta, së bashku me zarfin për shërbimin postar pranë zyrës së protokollit të ASHK-së . Ky dorëzim duhet të bëhet çdo ditë nga ora 13.00-15.00. Fakti i depozitimit të dokumentacionit mbahet dhe dokumentohet në një libër të veçantë të protokollit (libri i noterëve).
- ASHK mundëson përpunimin e praktikës, pas aplikimit online nga ana e noterit dhe administrimit fizik të dokumentacionit origjinal të praktikës të aplikimit të kryer. Pas

verifikimit të informacionit dhe dokumentacionit, kthimi i përgjigjes dhe dorëzimi i dokumentacionit nga ASHK bëhet në adresë të noterit nëpërmjet shërbimit postar.

- Në rastet e paraqitjes së kërkesës për informacion mbi gjendjen juridike për kryerjen e transaksioneve për tjetërsimin e pasurisë, kërkesa e noterit duhet të shoqërohet edhe nga çmimi përkatës i shitjes, me qëllim që ASHK të bëjë përlogaritjen e tatimit/taksës së kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme sipas çmimit të përcaktuar. Në këtë moment bëhet bllokimi i pronës për një afat 30 ditor. Me kalimin e këtij afati, nëse nuk realizohet shërbimi, bëhet heqja/fshirja e këtij bllokimi.
- Informacioni mbi gjendjen juridike të pasurisë ose/dhe të të drejtave reale mbi to, që u ofrohet noterëve nga ASHK, duhet të jetë i plotë, i saktë dhe në përputhje me dokumentacionin tekniko-ligjor të administruar në zyrë për pasurinë përkatëse.
- Monitorimi i ecurisë dhe zbatimi i afateve në trajtimin e kërkesave të noterëve nëpërmjet aplikimeve online, duke ruajtur radhën e paraqitjes së tyre, është detyrë e drejtorit vendor të ASHK-së.

Kushte Teknike të Nevojshme

Komunikimi në kohë reale midis palëve do të jetë funksional në momentin kur plotësohen kushtet e paraqitura sipas aktorëve të ndërlidhur nëpërmjet sistemeve përkatëse të informacionit:

C.1 Dhoma Kombëtare e Noterisë

- DHKN do të implementojë platformën elektronike NISA në përdorim nga çdo Noter përmes zyrës noteriale, për të siguruar transferimin e sigurt dhe të shpejtë të të dhënave.
- DHKN në bashkëpunim me AKSHI-n do të sigurojë kushtet teknike për hartimin e akteve të nënshkruara elektronikisht, duke siguruar qartësisht autorësinë e noterit në lidhje me aktin noterial.

C.2 Agjencia Shtetërore e Kadastrës

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të mundësojë Regjistrin Shtetëror Elektronik të Kadastrës për noterët për qasje në të dhënat e Pasurive të Paluajtshme.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të mundësojë ofrimin e të dhënave elektronike duke u konsultuar me bazën e të dhënave ALBSReP për:
 - Të dhënat identifikuese për pasuritë (Zona kadastrale, Numri i Pasurisë, Adresa, Volum, Faqe, etj.)
 - Përshkrimi i pasurisë (Sipërfaqja, Lloji i pasurisë, etj.)
 - Pronësinë/mbajtësin e të drejtave pronësore dhe ose të të drejtave reale (Emri/at i/e pronarëve, shuma e paguar, data e transaksionit, etj.)
 - Dokumentacioni i ruajtur në format elektronik për një pasuri kur ajo disponohet sipas këtij formati në DVASHK-të¹ përkatëse.

¹ Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

- Në vijim të përmirësimeve teknologjike që ASHK do të ndërmarrë, përfshijnë në analizat funksionale të gjitha kërkesat e trajtuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.
- Çdo ndryshim që mund të pasojë këtë Marrëveshje e në vijim, palët duhet të vihen në dijeni që në Draft-mendime, në mënyrë të atillë që të bashkërendojmë ndryshimet përkatëse ligjore dhe/ose në sistemet TIK² të ASHK-së.

Aspekti teknik i komunikimit të Databaza-ve Shtetërore: NISA³ - ALBSReP⁴

Platforma elektronike NISA do të ofrojë mundësinë e aplikimit elektronik nga çdo zyrë noteriale drejt Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për shërbimet noteriale që ofrohen në bazë të legjislacionit në fuqi.

Nga ana tjetër, Sistemi Elektronik i ASHK-së do të ofrojë mundësinë e kthimit të përgjigjes për çdo kërkesë të kryer nga Noteri, përgjigje e cila do të procesohet nga Platforma Elektronike NISA.

Dhoma Kombëtare e Noterëve nëpërmjet Sistemit NISA i cili i shërben noterë-ve (për aplikimet e qytetarëve, bizneseve, institucioneve bankare, zyra ve ligjore, etj.), duhet të mundësojë:

- Gjurmueshmërinë e aplikimit për shërbim.
- Marrjen e përgjigjes dhe printimin e saj në format zyrtar.
- Regjistrim dhe procesim ankesash kundrejt një aplikimi apo shërbimi të caktuar.
- Printim të Certifikatave të Pronësisë dhe Kartelave me vulë digjitale.
- Njoftim me e-mail/SMS për statuset e aplikimit ose përgjigjeve.
- Formatin e ruajtjes së dokumenteve të lidhura me aplikimin sipas kërkesave teknike të ASHK-së.
- Mekanizma auditimi, logimi dhe monitorimi.
- Krijim i një mekanizmi monitorimi të procesimit të aplikimeve sipas afateve në formatin e raportit.
- Formatin Teknik i Aplikimeve Elektronike të Noterit.

D.1. Formatin Teknik i Aplikimeve Elektronike të Noterit

- **Kërkesat në rrugë elektronike klasifikohen në katër grupe kryesore:**

NISA akseson ALBSReP për të tërhequr të dhënat përshkruese të një pasurie të paluajtshme për të cilën do të kryhet një transaksion noterial.

Marrja e të dhënave mbi gjendjen juridike të pasurive të paluajtshme, do të kryhet me një nga mënyrat e mëposhtme:

- merr të dhëna prone. Kjo metodë merr si parametra të dhënat e aplikantit (NID⁵, emër, atësi, mbiemër) dhe kthen pasuritë e këtij të fundit.

² Teknologjisë së informacionit dhe Komunikimit.

³ Notarial Information System of Acts-Sistemi i Informacionit të Akteve Noteriale.

⁴ Sistemit Elektronik i Pasurive të Paluajtshme.

⁵ Numri i identifikimit elektronik.

- getProperty - Kjo metodë merr si parametra disa të dhëna të pasurisë (zonën kadastrale, Volumin dhe Faqen).

NISA gjeneron **kërkesën** për ASHK-në për gjendjen juridike dhe dokumentet vërtetues të fakteve juridike të Dosjes së Pasurisë së Paluajtshme.

NISA përpilon një aplikim dhe thërret një metodë Postimi për këtë të fundit në ndërfaqen e ASHK-së. Metoda quhet ZrppSubmit . Parametrat e kësaj metode janë si më poshtë:

- Të dhëna për aplikantin (EmriPronarit, CmbDokumentacioni ,NID, IDDokumenti, Adresa, NrCelular, Email, ID, Informacioni, NIDHuaj, CmbAplikanti).
- Të dhëna për përfaqësuesin (EmriPronarit, CmbDokumentacioni, NID, IDDokumenti, Adresa, NrCelular, Email, ID, Informacioni, NIDHuaj, CmbAplikanti, DatëProkure, NumërProkure për rastet kur përfaqësuesi nuk është i njëjtë me aplikantin).
- Të dhëna për pronën (ZonaKadastrale, Volumi , Faqe, NumërPasurie, PronaIndeksiHartës, Adresa me fushat PronaRrethi, PronaQytetiFshati , PronaRrugaLagja , PronaShkalla, PronaPallatiGodina ,PronaApartamenti ,PronaKati ,IdProne, IDPartyMember).
- Të dhënat e dokumenteve që i ngarkohen aplikimit (pa pjesën e përmbajtjes) (EmriDokumentit , ID, Origjinal, Kryesor, NumriFleteve, IDShërbimi, Data, TipiDokumentit).
- Të dhënat për shërbimet për të cilat po bëhet kërkesë përmes aplikimit (TaxForDays, EmriShërbimit, Sasia , Tarifa , Gjoha , Taksa , IdSherbimi , TarifaTotale , DaysToComplete, KodiShërbimit).
- Të dhëna të tjera të aplikimit (Tatim, Taksë, TatimPropertyTypeID, ÇmimiBlerje, ÇmimiShitje, Koeficienti , VleraBlerje , VleraShitje, Sipërfaqja, DataKontratëShitje, DataDokumenti, VitiFitimiPronësisë, VitiRegjistrimiPronësis, VleraLekKontrataAktualeShitje , VleraLekBlerjeKontrataParaardhese, ShumaPërTuTatuar, TatimiPërTëPaguar, NrKol , NrRep, SipërfaqjaTaksa, Zona, LlojiPasurisë, TaksaPërTuPaguar, ZvrppID).
- Gjithashtu thërret edhe një metodë nëpërmjet së cilës bën ngarkimin e dokumenteve të certifikuar elektronikisht (përmbajtjet e tyre) që i bashkëngjiten aplikimit. Metoda që i shërben këtij qëllimi quhet Attachment dhe ka parametrat : File , EmriDokumentit , ID , Origjinal , Kryesor , NumriFleteve, IDShërbimi, TipiDokumentit , ZvrppID , ZK , CaseId.

NISA gjeneron Kërkesë për ASHK-në për llogaritjen e Tatimit përpara regjistrimit të Kontratës së Shitblerjes pranë ASHK-së

Metoda që i shërben llogaritjes së tatimit për individët është PërlllogaritTatim me parametrat : VleraLekAktuale , VleraLekParaardhese, TotaliVlerësShitje, TotaliVlerësBlerje.

Metoda që i shërben llogaritjes së taksës për subjektet është PërlllogaritTaksë me parametrat: sipërfaqja, çmimi i shitjes , zona , lloji i pasurisë.

NISA dërgon kontratën e certifikuar elektronikisht nga Noteri për regjistrim pranë Drejtorisë Vendore dhe/ose Zyrës Vendore përkatesë të ASHK-së.

Procedura në NISA është e njëjtë me atë të trajtuar në pikën 2. Thërriten metodat e postimit (ZrppSubmit) dhe të ngarkimit të dokumenteve (Attachment). Në këtë rast një nga dokumentet e bashkëngjitur aplikimit është Kontrata e Certifikuar Elektronikisht.

NISA mund të dërgojë jo vetëm dokumentin e certifikuar elektronikisht, por edhe një dataset të caktuar me marrëveshje në format të strukturuar të metadatave, për t'u procesuar me tej nga institucioni pritës (në rastin konkret ASHK), kjo si një ndihmë që i jepet ASHK-së për të integruar këto të dhëna në sistemin e vet në back office.

1- NISA përpunon rastet e Akt Verifikimeve të dërguara nga ALBSReP .

NISA mund të procesojë elektronikisht Aktet e Verifikimit për rastet e aplikimeve të gabuara nga ana e Noterit, sipas kërkesës të dërguar nga ASHK nëpërmjet sistemit të vet elektronik.

D.2 Formati Teknik i Përgjigjes së Aplikimit nga ALBSReP

Përsa i takon kërkesave të dërguara nga Noteri pranë sistemit elektronik të pasurive të paluajtshme, ASHK merr përsipër si më poshtë vijon:

- Ofrimin e të dhënave elektronike duke u konsultuar me bazën e të dhënave ALBSReP për:

1- ALBSReP ofron të dhëna përshkruese të një pasurie të paluajtshme

- Të dhënat identifikuese për pasuritë (Zona kadastrale, Numri i pasurisë, Adresa, Volum, Faqe, etj.)
- Përshkrimi i pasurisë (Sipërfaqja, Lloji i pasurisë, etj.)
- ALBSReP ofron përgjigje për kërkesën nga NISA për gjendjen juridike **dhe dokumentet vërtetues të fakteve** juridike të Dosjes së Pasurisë së Paluajtshme.
- Dokumentacioni i ruajtur në format elektronik për një pasuri kur ajo disponohet sipas këtij formati në DVASHK-të përkatëse (Kartela / Harta Treguese etj).
- ALBSReP ofron **përgjigje për tatimin e përllogaritur** dhe detyrimet **përkatëse sipas të dhënave të Kontratës së Shitblerjes** (Emri/at i/e pronarëve, shuma e paguar, data e transaksionit, etj.), kontratës së dhurimit, shkëmbimit, heqjes dorë etj.
- ALBSReP proceson Kontratën e Certifikuar Elektronikisht nga Noteri për të vijuar me procesin e Regjistrimit pranë **Kadastrës** dhe kthen **përgjigje tek NISA** në momentin e përfundimit të procesit të regjistrimit.

Në momentin që merr përgjigje një aplikim i kryer nga DHKN, automatikisht bëhet pasqyrimi në sistemin ALBSReP.

2- NISA dërgon Akt Verifikimi për Aplikime të kryer nga Noteri.

- Në momentin që konstatohet një gabim në aplikim, sistemi ALBSReP dërgon kërkesën për Akt Verifikimi në formë elektronike drejt sistemit NISA, duke identifikuar Aplikimin e gabuar.
- Noteri do të kthejë përgjigje nëpërmjet NISA, për korrigjimin e gabimit apo plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga ASHK.

NISA mund të procesojë elektronikisht Aktet e Verifikimit për rastet e aplikimeve të gabuara nga ana e Noterit, sipas kërkesës të dërguar nga ASHK nëpërmjet sistemit të vet elektronik

Ndikimi i përmirësimeve teknologjike në Marrëveshjen e lidhur midis palëve



Dhoma Kombëtare e Noterisë

Dhoma Kombëtare e Noterisë siguron mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të platformës elektronike NISA, për një periudhë të gjatë kohore. DHKN siguron përmes platformës NISA përmirësimin e vazhdueshëm të komponentëve Hardware dhe Software të sistemit. Përmirësimet e nevojshme në lidhje me këtë platformë do të lidhen, si me përmirësimin e shërbimeve publike noteriale, ashtu dhe me përmirësimet në drejtim të zhvillimit dhe implementimit të teknikave të reja kompjuterike në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Përmirësimet apo upgrade të Platformës Elektronike NISA, synojnë të përmirësojnë në vijimësi komunikimin elektronik me ASHK-në, duke mos afektuar thelbin e komunikimit juridik midis Palëve.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Në vijim të përmirësimeve teknologjike, ASHK merr përsipër për përfshijë në analizat funksionale të gjitha kërkesat e trajtuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe në këtë Aneks Teknik.

A handwritten signature consisting of several overlapping loops and curves, written in black ink.A handwritten signature consisting of a single, long, sweeping stroke that forms a large loop and ends in a sharp point, written in black ink.

• LISTA E SHËRBIMEVE ONLINE TË OFRUARA PËR NOTERËT NGA ASHK

- Regjistrimi i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve
- Regjistrim i kontratës së shitjes
- Regjistrimi i kontratës së dhurimit
- Regjistrimi i deklaratës për heqje dorë nga pronësia
- Regjistrimi i kontratës së shkëmbimit
- Regjistrimi i kontratës së qirasë apo nënqirasë
- Regjistrimi i aktit të trashëgimisë
- Konsultimi i kartelës së pasurisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme
- Verifikimi online i gjendjes juridike dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme
- Informacioni zyrtar i pasurisë për individët dhe institucionet
- Lëshim kopje të fragment hartës kadastrale
- Lëshim kopje kartelesh të pasurisë
- Lëshim certifikatë pronësie
- Lëshim vërtetim pronësie
- Lëshimi i një certifikate të re kur ka humbur apo është dëmtuar certifikata e marrë
- Regjistrimi i aktit noterial për pezullimin e veprimeve të regjistrimit
- Regjistrim/ndryshim/shuarje servituti
- Regjistrim i kontratës me rezervë/kusht i pasurisë
- Regjistrim i prokurës
- Korrigjim gabimesh në kartelë
- Korrigjim gabimesh në hartën kadastrale
- Korrigjim gabimesh në certifikatën e pasurisë së paluajtshme
- Regjistrim i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës për kredi (me vlerë deri në 1.000.000 lekë , me vlerë 1.000.000-10.000.000 lekë, me vlerë mbi 10 000. 000 lekë)
- Regjistrimi apo fshirje e kontratave të tjera të hipotekës
- Regjistrimi apo fshirje e hipotekës ligjore.

